



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

VENDIM

NR. 2, DATË 20.12.2012

**PËR PËRCAKTIMIN E PROJEKTIT TË GAZSJELLËSIT TRANS ADRIATIK (TAP)
SI ÇESHTJE TË RËNDËSISË KOMBËTARE
NË PLANIFIKIMIN E TERRITORIT**

Në mbështetje të nenit 5, 6, 8, 32, 34, 36, 37 dhe 64 të Ligjit Nr. 10119, date 23.04.2009 "Për Planifikimin e Territorit", i ndryshuar, VKM nr. 459, datë 16.6.2010 "Për miratimin e standardeve të përbashkëta gjeodezike dhe GIS" dhe VKM Nr.87 datë 07.02.2012 "Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit",

me propozim të Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit,

KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

VENDOSI:

1. Përcaktimin e Projektit të Gazsjellësit TAP si Çështje të Rëndësisë Kombëtare në Planifikimin e Territorit.
2. Shpalljen "zonë kombëtare" të korridorit me gjerësi 500 m të Projektit TAP, sipas kufijve të territorit paraqitur në hartën perkatëse, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pezullimin e zhvillimit në këtë zonë deri në hyrjen në fuqi të Planit Kombëtar Sektorial për Projektin TAP.
3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të vazhdojë procedurat për hartimin e Planit Kombëtar Sektorial për Projektin TAP, sipas afateve të paraqitura në Shtojcën II, bashkëlidhur këtij vendimi.

4. Vërejtjet dhe propozimet e palëve të interesuara për dokumentin e Planit Kombëtar Sektorial të Projektit TAP do të depozitohen pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në përputhje me afatet e hartimit, këshillimit dhe bashkërendimit të këtij plani sipas Shtojces II, bashkëlidhur këtij Vendimi.
5. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit të shqyrtojë përputhshmërinë e Planit Kombëtar Sektorial të Projektit TAP me instrumentat ekzistuese të planifikimit të territorit, në fuqi.
6. Brenda 10 ditëve nga marrja e këtij Vendimi, AKPT-ja e boton atë në Regjistrin e Planifikimit të Territorit dhe ua dërgon të gjitha autoriteteve të planifikimit nëpërmjet mjeteve tradicionale të informimit.
7. Ky vendim shfuqizon Vendimin e KRRTRSH-së Nr.1 dt. 14.08.2007 "Për miratimin e gjurmës së gazsjellësit Trans Adriatik, në territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe linjës për stokimin nëntokesor të gazit"
8. Shtojca I dhe shtojca II i bashkëngjiten këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.
9. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**KRYETAR
I KËSHILLIT KOMBËTAR TË TERRITORIT**

SALI BERISHA




ZËVENDËS KRYETAR I KKT

SOKOL OLLDASHI

MINISTËR I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT



SEKRETARE E KKT

KREUZA LEKA

DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT



